



A.nr.08/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shaban, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.08/2026, të datës 08.01.2026, të parashtruar nga ankuesi, B.A. nga Prizreni, kundër organit të punësimit: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 12.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.08/2026, e datës 08.01.2026, e parashtruar nga ankuesi, B.A.

II. Mbetet në fuqi Raporti i vlerësimit paraprak i datës 22.12.2025, i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe akti përfundimtar i datës 22.12.2025, të Komisionit të Pranimit, për përfundimin e procedurës së rekrutimit më numër reference RN00018979, pozita *Zyrtar i Lartë për Numeracion*, në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil B.A, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 08.01.2026 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë kundër Raportit-Njoftimit për vlerësimin paraprak në procedurën e rekrutimit më numër reference RN00018979, për pozitën *Zyrtar i Lartë për Numeracion*, të shpallur nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare më datë 11.11.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe

Postare, ndërsa, kjo e fundit, më datë 27.01.2026, ka përcjellë përgjigjën në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 19/2026 të datës 08.01.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Njoftimin/Raportin e vlerësimit paraprak të datës 22.12.2025; ID e ankuesit; Konkursin e datës 11.11.2025; Vendimin Nr.2562 për fillimin e procedurës për plotësimin e pozitës me afat të përcaktuar Zyrtar i Lartë për Numeracion; Listën e aplikanteve; Njoftimin për listën e kandidateve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vazhdim të procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018979, për pozitën “Zyrtar i lartë Numeracion”; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit për pozitë profesionale brenda ARKEP; Akt emërimit e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Shpalljen e njoftimit për pozitën RN00018979 e datës 06.01.2026; Listën me renditjen përfundimtare të kandidateve; Listën e pyetjeve; Aplikacionin e ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është ***e pabazuar, sepse:***

Gjendja e fakteve

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

-Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me datë 11.11.2025, ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00018979, për Grupin e Inxhinierisë së telekomunikacionit, respektivisht për pozitën *Zyrtar i Lartë për numeracion*, në Divizionin për Numeracion dhe Bartshmëri të Numrave, klasa e pozitës profesionale 1, një (1) vend pune, me afat të aplikimit nga data 12.11.2025 deri më datën 11.12.2025.

-Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe se i njëjti nuk ka arritur të kalojë fazën e verifikimit paraprak, rrjedhimisht, sipas Raportit të Vlerësimit Paraprak të datës 22.12.2025, të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se: Diplome (nuk është e bashkangjitur) dhe përvoja e punës nuk është në përputhje me kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër reference RN00018979.

-Tutje, sipas shkresës të datës 06.01.2026, të Kryetares së Komisionit të Pranimit, rrjedhë së asnjë nga tre (3) kandidatet të cilët kanë marrë pjesë në testin me shkrim nuk e ka kaluar testin me shkrim, duke u rekomanduar përsëritja e procedurës së konkursit.

Pretendimet Ankimore

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Raportin për vlerësim paraprak të datës 22.12.2025, lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën *Zyrtar i Lartë për Numeracion*, me pretendimet se i njëjti ka qenë i regjistruar në platforme dhe se ka bashkëngjitur diplomën e studimeve themelore, ndërsa, lidhur me përvojën e punës

pretendon se ka përvojë të punës sipas kërkesave të konkursit sepse që nga data 25.10.2025 dhe vazhdon të punoj si Menaxher për pomp dhe market në Petrol Company në Prizren.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “ *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit publik me numër reference RN00018979, respektivisht për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë për Numeracion*” dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **-Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor në fushën: Specialist i Inxhinierisë së Telekomunikacionit, -Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.**

Kolegji i Këshillit në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohej se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: *2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Andaj, referuar bazës ligjore si me sipër, e në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të ankuesit i dorëzuar nga njësia përgjegjëse e ARKEP, dhe si rrjedhojë Kolegji ka gjetur se ankuesi me rastin e aplikimit nuk ka të bashkangjitur ndonjë dëshmi lidhur me kriterin e arsimit, ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës posedon Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës të datës 14.11.2025, të lëshuar nga biznesi “Petrol Company” sipas të cilës dëshmi konfirmohet se ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë këtij biznesi dhe atë nga data 25.10.2015 e tutje si Menaxher

për pomp dhe market e dëshmuar edhe me dëshmi nga Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, e mbi këto fakte, Kolegji i Këshillit, konstaton se njësia përgjegjëse në këtë rast Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, sepse, ankuesi nuk posedon dëshmi lidhur me kriterin e arsimit dhe në mungesë të diplomës, përvoja e deklaruar e punës nuk mund të vërtetohet nëse ka të bëjë me përudhën pas diplomimit dhe se kjo përvojë i referohet pozitës së shpallur.

Duke qenë se asnjëri nga kandidatet e përfshirë në vlerësimin profesional përmes testit me shkrim nuk ka arritur numrin e mjaftueshëm të pikëve për të vazhduar në fazën tjetër të vlerësimit gjegjësisht me intervistë, siç përcaktohet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, atëherë, edhe procedura përkatëse e pranimi nuk ka mundur të vazhdojë me tej, kështu që, duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.08/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, B.A.
- Udhëheqësit të Personelit/ Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.